



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRES
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr.Prot. _____

Durrës, më / /2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbim per akomodimin e 2 menaxhereve turq” per Spitalin Rajonal Durres , - Procedure e Hapur e Thjeshtuar , Sherbime ,marreveshje kuader me nje Operator Ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara , me afat 12 muaj .

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
55110000-4 /Shërbime të akomodimit në hotele**

VLERA E FONDIT LIMIT:

3’115’129 (Tre milion e njeqind e pesembedhjete mije e njeqind e njezet e nente)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Durres, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- *c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- *b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. KANDIDATI/OFERTUESI DUHET TË DORËZOHË:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Licencë të lëshuar nga Organi kompetent ku objekti I veprimtarisë së tij të ketë të përfshirë objektin e procedurës së prokurimit

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin përcaktohet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar*

në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës si dhe ne perputhje me pikën 4)a të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, siaps të ciles Autoriteti mund ti kerkoje OE per te provuar pershatshmerine per te kryer veprimtari profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale te paraqese licenca profesionale per realizimin e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore;

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne nenin 51 te Ligjit 93/2015 “Per turizmin”i ndryshuar sipas te operatori turistik perpara fillimit te ushtrimit te veprimtarise se tij pajiset me license sipas Ligjit 10081, date 23.02.2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”te ndryshuar

- Certifikata e kategorizimit ku percaktohet kategoria dhe niveli perkates i struktures akomoduese , me afat vlefshmerie brenda afatit të ekzekutimit të kësaj kontrate.

Argumentim: Në bazë të pikës 1, të nenit të 4, të VKM nr. 730, datë 20.10.2016 “Per miratimin e rregullores per kushtet, kriteret,tarifat dhe afatet dhe proceduren per klasifikimin e strukturave akomoduese(Ndryshuar me VKM nr.370, date 29.05.2019, nr.415, date 19.06.2019)kerkohet qe cdo sipermarres turistik qe ushtron veprimtarine si strukture akomoduese, duhet te pajiset me certifikate klasifikimi per ushtrimin e ketij aktiviteti.

3. **KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:**

- Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogel se 20 % e vleres se perllogaritur te kontrates

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt sherbime me fond limit ndermjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore te kerkuar nuk duhet te tejkaloje vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor per besueshmerine dhe qendrushmerine e tij.

4. **KAPACITETI TEKNIK:**

- Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates , në një jo më te vogel se 20 % e vleres se perllogaritur te kontrates për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet

vlera, afati i përfundimit të kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotsuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin shtetëror, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të një ose disa nga kontratat e mëparshme të ngjashme, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontrates, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotsuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më shumë se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK, referuar nenit 47 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

- Operatori Ekonomik të paraqesë një deklaratë me anë të ciles tregon që disponon fuqinë punëtore të dosmosdoshme për realizimin e shërbimit sipas specifikimeve teknike të vendosura nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Operatori duhet të ketë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” dhe ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor” të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 79 pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku ndër të tjera është përcaktuar se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”

Gjithashtu është në përputhje me nenin 123 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.

2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Dhe me **pikën 5/c të nenit 41** të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, ku përcaktohet se: *Për të provuar se,*

operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës dhe pika 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

- Akt Miratimi Higjieno – Sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, te vlefshme.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me piken 4 te nenit 77 dhe nenit 123 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se :

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Si dhe ne perputhje me VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe pika 5/c) Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

- Akt-Teknik i leshuar nga PMNZH për mbrojtjen ndaj zjarrit, i vlefshem.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me piken 4 te nenit 77 dhe nenit 123 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Si dhe ne perputhje me VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer

veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a)** licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; **dhe pika 5/c)** Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: **c)** operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

- Certificate DDD per ambientet e strukture akomoduese, te leshuar nga nje operator i licensuar, te vlefshme.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me piken 4 te nenit 77 dhe nenit 123 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohen se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin.2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Si dhe ne perputhje me VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe pika 5/c) Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës*

5. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Bazuar në Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare” neni 4 pika 3 e tij , një prej detyrimeve të palës shqiptare është

3. “Të mbulojë shpenzimet akomodimit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke...”.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor,

Për shërbimin e fjetjes:

Për shërbimin e fjetjes:

Operatori Ekonomik fitues duhet të mbulojë fjetje në dhoma standarte teke

Arredimi dhe mobilimi i dhomave duhet të ofrojë kushte optimale dhe të kënaqshme për qëndrimin/jetesën.

Akomodimi në hotel do të jetë për 2 persona në natë

Koha e qëndrimit :minimalisht 6 muaj(me te drejte rinovimi)

Ngrohje dhe ftohje me kondicioner në dhomë dhe secila dhomë të ketë tualet

Pastërtia dhe higjiena janë themelore në të gjitha kategoritë.Ambienti të plotësojë kushtet e higjienës në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme te hotelit (dyshemetë, muret, tavanet, mobiljet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjeter pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera) si dhe të jetë me termoizolim.

Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet të jenë funksionale dhe në gjendje pune.

Të jetë i instaluar sistem për mbrojtjen nga zjarri.

-Dhomat:

Sipërfaqja e dhomave të jenë të përshtatshme për aq persona sa do të akomodohen, duke përfshirë tualetin.Shtretërit të jenë me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur.

Seti i çarçafëve të jenë një cilësi e lartë. Mbulesat/jorganët të jenë me vatinë ose pupla ose ekuivalente.Modeli i jastëkut të jetë bashkëkohor dhe i mirëmbajtur. Dhomat të jenë me perde.Dhomat të kenë dollapë të përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura gjithashtu dhe një numër të përshtatshëm varësesh rrobash. Gjithashtu dhomat të kenë të paktën një karrige, një tavolinë , një prizë elektrike të aksesueshme në dhomë si dhe një televizor.Ndriçimi të jetë i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës.

Dhomat të jenë me ajër të kondicionuar / sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektive.

-Tualetet :

Tualetet e të gjitha dhomave të jenë të gjitha me dush dhe VC ose vaskë dhe VC . Muret e tualeteve të jenë me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.)

Dyshemeja e tualetit të jetë me material kundër rrëshkitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme etj.) Lavamanët të jenë me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë.Në cdo tualet të ketë pasqyrë, mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë gripi, aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit, kosh mbeturinash, sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë, shampo trupi dhe flokësh, 1 peshqir të vogël për person, 1 peshqir të madh për person.

-Pastrimi dhomës dhe tualeteve në dhomë.

Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës të personelit.Ndërrim i çarçafëve minimalisht 1

(një) herë në 3 (tre) ditë dhe me kërkesë të personelit sipas rastit.

-Të ndryshme:

Të gjitha shërbimet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm.

Hoteli merr përsipër të ofrojë ujë të pijshëm pa limit sipas kërkesave të personelit turk.

Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 3 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal Durres .

Hoteli të ofrojë shërbim 24 orësh gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës

Foto të brendshme dhe të jashtme të objektit.

Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 3 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal Durres.

OE duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje që vërteton vendndodhjen e Operatorit Ekonomik.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Ky Procesverbal u ngarkua në SPE nga Njësia e Prokurimit sipas modelit të APP, sipas materialit me nr. 35/1 date 13.01.2023 me titull ”Përgatitjen dhe Argumentimin e Specifikimeve Teknike, Kerkesave të vecanta Teknike për Kualifikim dhe Perlllogaritjem e Vleres Limit të Kontrates “ te dorezuar nga Njësia e Posacme e ngritur me urdherin e brendshem nr.prot. 35 date 09.01.2023 i perbere nga specialiste te fushes.

Njësia e Prokurimit :

- | | | |
|---------------|------------------------------------|-------------|
| • Ina Leka | (Sp.e Larte ne Sek. e Prokurimeve) | (Juriste) |
| • Enis Karaj | (Sp.e Larte ne Sek. e Prokurimeve) | (Ekonomist) |
| • Edison Rapi | (Pergjegjes i Sek. te Prokurimeve) | (Ekonomist) |